VENDIM
Nr.62, datë 29.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 12, shkronja "a", nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, nenit 59 pikat 2 dhe 3, nenit 60 dhe nenit 61, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja", miratuar me vendimin nr.57, datë 15.10.2007 të Këshillit Mbikëqyrës, të Bankës së Shqipërisë bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 11, paragrafi 1, shprehja...njëkohësisht..." zëvendësohet me shprehjen "..të paktën një nga...";

b) Në nenin 11, paragrafi 1, shkronja "a", bëhet:

"...vlera mesatare e aktiveve të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi, nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar";

c) Në nenin 11, paragrafi 1, shkronja "b", bëhet:

"vlera mesatare e depozitave të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të depozitave të sistemit bankar.".

d) Në nenin 13, paragrafi 1, bëhet si më poshtë:

"… Në zbatim të kërkesave dhe detyrimeve të kësaj rregulloreje, dega raporton në Bankën e Shqipërisë respektivisht çdo muaj sipas formularit nr.1 dhe çdo tre muaj sipas formularit nr.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani